



BASHKIA MIRDITË
SEKTORI PROKURIMEVE

Rreshen, me ____/____/2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Shenim: Kjo procedure zhvillohet mbi bazen e parashikimeve të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”

OBJEKTI I PROKURIMIT:

**PUNIME RINDERTIMI NE “RIKONSTRUKSION DHE RIPARIM TË MJEDISEVE NË
BASHKËPRONËSI OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA (PALLATE), NE QYTETIN
RRESHEN DHE RUBIK (FAZA 3)” BASHKIA MIRDITE.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punime ndërtimi.

VLERA E FONDIT LIMIT: 192’851’638 Lek (njqind e nentedhjete e dy milion e teteqind e pesedhjete nje mije e gjashteqind e tridhjete e tete) Leke, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Mirdite ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”si dhe nenit

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit apo nevojën që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës në procedurën e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:Kjo vlere eshte percaktuar referuar parashikimeve te nenit 43/2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet se: ” Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetare”, si dhe mbi bazen e nenit 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar l

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2018, 2019, 2020, të konfirmuara nga autoriteti perkates, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit Nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, te nenin 41 te ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e maturuara të taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2021, sipas afateve të përcaktuara në ligjin 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e informacionit të paraqitur.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, ku përcaktohen llojet e taksave dhe detyrimeve vendore si dhe detyrimet e subjekteve për pagimin e tyre, sipas afateve perkatese.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

***Pika 2.3.1/a,** plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

i) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- Formularin e vlerësimit
- Situacionin Perfundimtar te punimeve
- Fatura tatimore për situacionin perfundimtar

ii) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- Akti kolaudimit
- Situacionin Perfundimtar te punimeve
- Fatura tatimore për situacionin perfundimtar

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.2.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

(Shënim: të përcaktohen dokumentet konkrete që kërkohen për të dëshmuar përvojën e mëparshme të ngjashme me sektorin privat, të cilat janë të nevojshme dhe i shërbejnë AK për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar qe nje punë e mëparshme të ngjashme (për një objekt të vetëm), të jenë minimalisht në vlerat 95 000 000 (nentedhete e pese milione), dhe kjo vlere eshte brenda kufirit maksimal te parashikuar ne nenin 39/5/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”., ku parashikohet se: ”Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”

Për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e kontratave të punëve të kryera e marrë së bashku gjatë 5 viteve të fundit është në një vlerë jo me te vogel se 384 000 000 (treqind e tetedhjetë e kater million) qe eshte kerkuar vlera që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar (neni 39/5/b parashikon: Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë vjetëve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet”.

Shënim: *(Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi).*

2.3.2. Në bazë të neni 39 te LPP, kur punët prokurohen me kontratë me çelësa në dorë:

- i. Kur autoriteti kontraktor nuk ka hartuar projektpreventiv, por ka vetëm një projektide, apo detyrë projektimi dhe terma reference për objektin që prokuron.

Në këtë rast, autoriteti kontraktor kërkon nga kontraktori hartimin e projektpreventivit, si dhe realizimin e punimeve të zbatimit të këtij projekti, pas miratimit paraprak të tij nga autoriteti kontraktor.

Autoriteti/enti kontraktor duhet të kërkojë nga ofertuesit disponimin e kapaciteteve teknike për realizimin e secilës fazë të sipërcituar: për hartimin e projektit, si dhe për realizimin e tij, duke lejuar edhe mundësinë që projektimi mund të nënkontraktohet, apo që ofertuesi (zbatuesi i punimeve) të paraqesë kontratë bashkëpunimi me subjekte që operojnë në fushën e projektimit dhe që plotësojnë të gjitha kriteret e hartuara nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë qëllim. Në këtë rast kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, sipas projektpreventivit të miratuar paraprakisht nga autoriteti kontraktor, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.

Për sa më sipër ofertuesit duhet te disponojnë kapacitetet teknike për hartimin e projektit në njërën në format e përmendura nga neni 39 i LPP, i cili të disponojnë licencat:

2. Projektues Arkitekt:

- a. -Projektim arkitekturor per objekte banimi-objekte industrial-objekte turistike.
- d. -Projektim peizazhi, sistemim siperfaqe te gjelbera, lulishte e parqe.

3. Projektues Konstruktor:

- a. -Projektim objekte civile-turistike-industriale prej murature e skelet b/a deri ne 5 kate.

4. Projektues Instalator:

- a. -Projektim te instalimeve hidrosanitare
- c. -Projektim te linjave e rrjeteve elektrike per objekte civile e industrial.
- f. -Projektim te sistemeve kundra zjarrit.
- j. -Projektim te rrjeteve te telefonise, citofonise, fonise, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit te zjarrit etj per objektet civile e industriale.

5. Projektues Vepra Hidraulike:

- b. -Projektim furnizim me uje – kolektore shkarkimi.
- c. -Projektim ujesjelles kanalizime urbane – rurale.

8. Projektues Gjeodet:

- a. -Rilevime inxhinierike.

10. Projektim i impianteve te prodhimit dhe shperndarjes se energjise elektrike;

- e. -Projektim kabina elektrike te rrjetit shperndares – linja te tensionit te ulet – te mesem.

(Shënim: përcaktoni kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas kërkesave të termave të referencës dhe detyrës së projektimit për punimet konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në klasifikimin e niveleve (germave) për punimet sipas natyrave respektive, të parashikuara në VKM Nr.42 datë 16.01.2008; *Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, i ndryshuar.

Në çdo rast, për secilin kategori licence, është përcaktuar niveli (germa) duke u nisur nga kërkesat e termave të referencës apo në specifikimet teknike për kërkesat e projektimit.

2.3.2/a Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- **N.P – 1 / A** Punime gjurmimi në tokë.
- **NP-3 / D** Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile dhe industriale, veshje fasada.
- **NP-12 / A** Punime të inxhinierisë së mjedisit

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- **NS-1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve.
- **NS-2 / A** Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre.
- **NS-4 / C** Punime rifiniture të muratës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami.
- **NS-14 / A** Impjante të brendshme elektrik telefoni, radiotelefoni, tv, etj.
- **NS-18 / A** Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

(Shënim: përcaktoni kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ne klasifikimin e niveleve (germave) per punimet sipas natyrave respektive, te parashikuara ne VKM Nr.42 date 16.01.2008; *Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.*

Ne cdo rast, per secilen kategori licence, eshte percaktuar niveli (germa) duke u nisur nga vlere e punimeve ne parashikuara ne preventiv dhe/apo ne specifikimet teknike.

(Shënim: përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor që parashikon licencimin në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit, kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

Inxhinier Ndertimi	2 (dy)
Inxhinier ndertimi (Profili strukturist)	1 (nje)
Arkitekt	2 (dy)
Inxhinier Elektrik	1 (nje)
Inxhinier Hidroteknik	1 (nje)
Inxhinier Gjeodet	1 (nje)
Inxhinier Elektronik	1 (nje)
Inxhinier Mjedisi	1 (nje)

Secili prej pjestarëve të drejtuesve teknik të mësipërm, duhet të jetë në **Listëpagesat te pakten 3 muajt e fundit si** dhe të figurojnë në **licensën e shoqërisë**.

Per secilin prej pjesëtareve të stafit duhet të paraqitet:

- **kontratë noteriale pune e vlefshme**
- **diploma**

ARGUMENTIMI: Kjo kerkese eshte hartuar mbi bazen e parashikimeve te VKM Nr.42 date 16.01.2008; *Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, i ndryshuar., sipas te ciles, “Drejtues teknik”- individi/ët e diplomuar në degët përkatëse të universitetit që janë është/jane përgjegjës/a për ndërtimin e objekteve sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Ne rastin konkret, ne projekt-preventivin dhe specifikimet teknike, jane parashikuar punime ndertimore, arkitektuore, ne rrjetin elektrik, instalime elektronike, punime hidraulike, punime mjedisore dhe rilevime te ndryshme mjedisore dhe per kete arsye, per realizimin e punimeve ne fjale jane kerkuar inxhinieret, drejtues teknik sipas profileve dhe profesioneve perkatese. Numri I tyre eshte bere nisur nga sasite e medha te cdo zeri punimesh ne preventive dhe dhe natyren komplekse te objektit te kesaj kontrate.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te kete staf te certifikuar si me poshte:

- **1 (një)** Inxhinier qe duhet të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi trajnimi (specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) që tregon pjesëmarrjen e tij në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private, sipas kërkesave të ligjit Nr. 10237 date 18.02.2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune” dhe V.K.M. Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.
- **1 (nje)** inxhinier i cili të disponojë certifikatë për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave.
- **1 (nje)** ekspert zjarrefikes te licensuar.

Per stafin e kerkuar si më sipër, duhet të paraqitet: Certifikatat perkatese te dhëna nga një organizëm i licensuar/certifikuar certifikimi shqiptar ose i huaj, kontrata e punes, diplome, si dhe te figurojnë ne listepagesat e kompanise **te pakten 3 muajt e fundit**.

- **1 (një)** Inxhinier qe duhet të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi trajnimi (specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) që tregon pjesëmarrjen e tij në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private, sipas kërkesave të ligjit Nr. 10237 date 18.02.2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune” dhe V.K.M. Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

ARGUMENTIMI: referuar ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune” dhe V.K.M. nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në

kantier”, gjate realizimit te punimeve te ndertimit ne nje kantier eshte e domosdoshme qe nje prej inxhinierëve te kete perva dhe specializimet e domosdoshme per te marre masat e nevojshme ne lidhje me për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë. Konkretisht, sipas nenit 6/1 te ligjit te sipercituar: ” Punëdhënësi, për sigurimin e mbrojtjes së punëmarrësve në të gjitha aspektet, që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë, merr masat e nevojshme nëpërmjet:parandalimit të rreziqeve për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale”.

- **1 (nje)** inxhinier i cili të disponojë certifikatë për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave:

ARGUMENTIMI: referuar ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune” dhe V.K.M. nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, gjate realizimit te punimeve te ndertimit ne nje kantier eshte e domosdoshme qe nje prej inxhinierëve te kete perva dhe specializimet e domosdoshme per te marre masat e nevojshme ne lidhje me për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.

Konkretisht, referuar pikes 10.1 dhe 10.2 Aneksit V “Zbatimi i masave për promovimin dhe përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve në punë”, V.K.M. nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, Ndhima e shpejtë 10.1 Punëdhënësi, duke marrë në konsideratë natyrën e aktivitetit dhe madhësinë e ndërmarrjes dhe të njësisve të prodhimit, pasi ka marrë mendimin e mjekut kompetent, aty ku është e parashikuar, merr masat e duhura në fushën e ndihmës së shpejtë e të asistencës mjekësore e të emergjencës, duke pasur parasysh praninë e personave të tjerë në vendin e punës e duke vendosur raportet e nevojshme me shërbimet e jashtme, dhe për transportin e punëmarrësve të aksidentuar.

10.2 Punëdhënësi, kur nuk i përcakton vetë, emëron një ose më shumë punëmarrës për zbatimin e masave në pikën 10.1. 10.3 Karakteristikat minimale të mjeteve të ndihmës së shpejtë, kërkesat e personelit dhe formimi i tyre përcaktohen në lidhje me natyrën e aktivitetit, numrin e punëmarrësve dhe faktorëve të rrezikut”

- **1 (nje)** ekspert zjarrefikes te licensuar.

Per stafin e kërkuar si më sipër, duhet të paraqitet: Certifikatat perkatese te dhëna nga një organizëm i licencuar/certifikuar certifikimi shqiptar ose i huaj, kontrata e punes, diplome, si dhe te figurojne ne listepagesat e kompanise se paku gjashte muajt e fundit.

ARGUMENTIMI: referuar Ligjit nr. 152/2015 datë 21.12.2015 ”Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” neni 38: ” 1. Personat fizikë e juridikë detyrohen të: a) zbatojnë dispozitat e parashikuara nga ky ligj dhe aktet e tjera nënligjore për sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin; b) marrin masa për parandalimin e pakësimin e zjarreve, me anë të mjeteve, sistemeve, pajisjeve të diktimit-sinjalizimit për shuarjen e zjarreve, gjatë kryerjes së aktivitetit të tyre; c) kontrollojnë, të paktën një herë në vit, gjendjen e masave, mjeteve dhe pajisjeve për sigurinë nga zjarri dhe

shpëtimin, në objektet dhe aktivitetet ku ushtrojnë veprimtarinë; ç) planifikojnë fonde financiare për ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës për sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin; d) planifikojnë fonde financiare për ngritjen e grupeve zjarrfikëse dhe trajnimin periodik të tyre; dh) pajisin strukturat e tyre me sisteme sinjalizimi, ndërlihdhjeje, sisteme stacionare automatike, me hidrantë zjarrfikës për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin, në përputhje me normat teknike, si dhe t'i mbajnë ato në gatishmëri; e) hartojnë rregullat e brendshme për sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin, në përputhje me rrezikshmërinë e proceseve teknologjike; 2. Objektet e çdo lloji, sipas shkallës së qëndrueshmërisë ndaj zjarrit dhe rrezikshmërisë ndaj tij, ndahen në kategori, të cilat miratohen me udhëzim të ministrit. 3. Projektimi, ndërtimi, rikonstruksioni dhe vënia në përdorim e veprave dhe strukturave të ndryshme, ndërtesave, rrjetit rrugor, elektrik, ujësjellës-kanalizimeve, pyjeve e kullotave, zonat e mbrojtura etj., bëhen në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. 4. Projektet për të gjitha llojet e ndërtimeve dhe administrimin e zonave të mbrojtura etj., përfshijnë edhe projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

Pra, referuar dispozitates se sipercituar dhe akteve te tjera nenligjore ne zbatim te ketij ligji, edhe subjektet juridike (sikurse jane ofertuesit/oe) qe do realizojne kete objekt, kane detyrime ne lidhje me MNZSH, qe lindin nga legjislacioni ne fjale dhe per rrjedhim duhet te kene stafin e kualifikuar per te permbushur keto detyrime.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë staf mbështetës të punësuar punonjesit e meposhtem:

a) Punonjes te diplomuar/specializur sipas legjisalcionit te aftesimit profesional:

- Teknik ndertimi	2 (dy)
- Specialiste punime elektrike	2 (dy)
- Specialiste punime elektronike	2 (dy)
- Specialiste per punime kondicionimi	2 (dy)
- Hidraulik	3 (tre)
- Karpentier	10 (dhjete)
- Murator dhe suvatues	10 (dhjete)
- Bojaxhi	5 (pese)

*Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; diploma ose certifikata profesionale, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **te pakten 3 muajt e fundit**. Diplomat/certifikatat qe nuk jane leshuar sipas legjislacionit perkates do te konsiderohen jote sakta dhe behen shkak per veprime te metejshme sipas parashikimeve perkatese te ligjit te prokurimit publik.*

b) Specialiste te certifikuar per përdorimin e skelave shoqeruar me certifikaten perkatese

7 (shtate)

*Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; certifikata të leshuar nga institucione të licensuara sipas legjisalcioniet perkatës , si dhe të figurojnë në listëpagesat eshoqërisë për **te pakten 3 muajt e fundit**.*

Argumentimi: Kjo kerkese është hartuar në përputhje me nenin 39/6/c/ç të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: ” *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*
c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Te gjithë specialistet e sipercituar janë kerkuar pasi në preventive janë realizuar punime për realizimin e të cilave nevojiten këta punonjes dhe numri i tyre është përcaktuar si numër minimal i nevojshëm për realizimin e punimeve respective.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë noteriale pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë **3 muajt e fundit 1 (një) mjek të përgjithshëm**. Në rastin e J.V cdo anëtar duhet të ketë të punësuar një Mjek të Përgjithshëm. Kjo gjithnjë referuar VKM Nr. 108, datë 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, i ndryshuar, ku parashikohen mënyrat e sigurimit të shërbimeve mjekësore, në bazë të numrit të punonjësve që punëdhënësit kanë të punësuar në subjektet e tyre, dhe sipas sektorëve të industrisë, të përcaktuara në këtë VKM.

Nëse OE nuk kanë personat e ngarkuar përgjegjës, me aftësi dhe kualifikimet e duhura, pra nëse nuk kanë mjek të punësuar, mund t’i sigurojnë këto shërbime me anë të marrëdhënieve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

Argumentimi: Në lidhje me kriterin për mjekun e shoqërisë, AK është referuar në VKM Nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, i ndryshuar me VKM Nr.632, datë 15.07.2015, ku parashikohen mënyrat e sigurimit të shërbimeve mjekësore, në bazë të numrit të punonjësve që punëdhënësit kanë të punësuar në subjektet e tyre, dhe sipas sektorëve të industrisë, të përcaktuara në këtë VKM, ku parashikohet domosdoshmeria e mjekut, në bazë të numrit të punonjësve që punëdhënësit kanë të punësuar në subjektet e tyre, dhe sipas sektorëve të industrisë, të përcaktuara në këtë VKM.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet te disponoje mjetet e meposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion me kapacitet mbajtes mbi 25 ton	Ne pronesi ose me qera	cope	2
2	Kamion me kapacitet mbajtes mbi 20 ton	Ne pronesi ose me qera	cope	2
3	Kamion me kapacitet mbajtes 10-15 ton	Ne pronesi ose me qera	cope	3
4	Kamion me kapacitet mbajtes 1-5 ton	Ne pronesi ose me qera	cope	5
7	Autobetoniere vetengarkuese mbi 3.5 m3	Ne pronesi ose me qera	cope	2
8	Autopompe Betoni	Ne pronesi ose me qera	cope	1
9	Autobot Uji	Ne pronesi ose me qera	cope	1
10	Eskavator me Goma	Ne pronesi ose me qera	cope	1
11	Fadrome me Goma	Ne pronesi ose me qera	cope	1
12	Skeleri	Ne pronesi ose me qera	m2	10,000
13	Pompe suvatimi	Ne pronesi ose me qera	cope	3
14	Autovinc	Ne pronesi ose me qera	cope	1
15	Motogjenerator	Ne pronesi ose me qera	cope	1
16	Betoniere	Ne pronesi ose me qera	cope	10
17	Vibratore	Ne pronesi ose me qera	cope	2
18	Matrapik	Ne pronesi ose me qera	cope	3
19	Depozita Uji 5000 L	Ne pronesi ose me qera	cope	2
20	Pompa Uji	Ne pronesi ose me qera	cope	2
21	Pirune ngrites per levizjen e materialeve	Ne pronesi ose me qera	cope	2
22	Ngrites peshash ne lartesi	Ne pronesi ose me qera	cope	2
23	Nivelues Lazer	Ne pronesi ose me qera	cope	1
24	Konteiner Ndertimi Stacioner	Ne pronesi ose me qera	cope	1
25	Vinc Kulle	Ne pronesi ose me qera	cope	1
26	Prerese Pllakash	Ne pronesi ose me qera	cope	2

- Kokore +Jeleke fosforoshente, minimumi 100 copë
- Ripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 30 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 10 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e

meposhtme:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë; - leja e qarkullimit, kontrolli teknik, siguracioni, leja e transportit dhe foto.
- Nëse për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimi, dhe fatura tatimore përkatëse, nëse për mjete të marrave qera krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në përfundimin e plotë të punimeve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht analizat e çmimeve janë hartuar sipas parashikimeve të VKM Nr.514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Në pikën 2 të VKM së sipërcituar parashikohet se: “*Hartimi i çdo preventivi apo situacioni në fushën e ndërtimit, si dhe zbatimi e mbikëqyrja e çdo punimi ndërtimi, që realizohet nga persona fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, me fonde publike ose private, në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhen në përputhje me këtë vendim*”.

Mbi bazën e kësaj VKM referuar zerave të preventivit është bërë përlllogaritja e numrit të punonjësve dhe numrit të mjeteve, sipas secilit tip apo lloj.

(Shënim: përcaktoni aktin ligjor apo nënligjor, në bazë të të cilit është bërë përlllogaritja teknike e numrit të punonjësve dhe mjeteve/makinerve/pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës)

2.3.8 Të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombëtare e licensimit (QKB) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mjetëve inerte”.

ARGUMENTIMI: Kjo kerkese eshte bere ne perputhje me nenin 44/1 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: *„Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO te lëshuara nga organizmat e vlerësimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, konkretisht:

- **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë “ lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim ose ekuivalentin e saj
- **OHSAS 18001:2015 ose ekuivalente 45000** mbi “Shëndetin dhe sigurimin në punë”, ose ekuivalentin e saj
- **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit” ose ekuivalentin e saj

ARGUMENTIMI: Kjo kerkese eshte bere ne perputhje me nenin 44/1 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: *„Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

2.3.10 . Cdo ofertues do te paraqese PLANIN E SIGURISE NE KANTIER per punimet ne nje objekt te ngjashem te realizuar ne format sipas VKM nr. 692 date 13.12.2001 “Per masat e vecanta te sigurimit dhe ruajtjes se shendetit ne pune, te ndryshuar me VKM nr. 742 date 06.11.2003 sipas kerkesave, si rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore dhe mbetjeve, ambientet e kantierit, rruge kalimet, tabelat e sig. teknik etj.

ARGUMENTIMI: Kjo kerkese eshte bere ne perputhje me VKM nr. 692 date 13.12.2001 “Per masat e vecanta te sigurimit dhe ruajtjes se shendetit ne pune, te ndryshuar me VKM nr. 742

date 06.11.2003 sipas kërkesave, si rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore dhe mbetjeve, ambientet e kantierit, rruge kalimet, tabelat e sig. teknik etj.

2.3.11 Operatori ekonomik për materialet si më poshtë:

- Bojrat

- Pllakat

-Materialet e termoizolimit dhe suvase (Polisterol, Rrjete, Grafiato, Llaç, Fino):

-Materialet hidroizoluese (Katrama, Hidroizolues bikomponent)

Per keto materiale operatori ekonomik duhet te paraqese kontrate furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar, katalogjet e ketyre materialeve me specifikimet perkatese te cilat duhet te korrespondojne me specifikimet e kerkuara . Dokumentacioni te permbaje identifikimim e qarte te aktivitetit te prodhuesit. Ne rastin e kontrates me distributorin te paraqitet marredhenia e distributorit me prodhuesin

ARGUMENTIMI: Kjo kerkese eshte bere ne perputhje me nenin 39 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe i sherben AK per tu siguruar mbi mbarevajtjen e zbatimit te kontrates dhe mbi marrjen e masave nga ana e ofertuesve per furnizimet e materialeve bazike, cka do te siguronte fillimin e menjehershem te punimeve sapo te nenshkruhet kontrata.

2.3.12 Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje kontrate te lidhur me nje laborator i cili te jete i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit per kryerjen e analizave per llacet,betonet etj.

ARGUMENTIMI: Kjo kerkese eshte hartuar mbi bazen e ligjit LIGJ Nr.10 489, datë 15.12.2011 “Për Tregtimin Dhe Mbikëqyrjen E Tregut Të Produkteve Joushqimore”, ne nenin 6/1 te te cilit parashikohet se: “Kur rregullat teknike përcaktojnë kërkesa thelbësore, produkti prezumohet se plotëson kërkesat thelbësore të rregullave teknike të zbatueshme ndaj tij, kur është në përputhje me të gjitha standardet e harmonizuara shqiptare përkatëse të botuara në Fletoren Zyrtare, që mbulojnë këto kërkesa thelbësore”.

2.3.13 Operatori Ekonomik duhet te paraqese kontrate furnizimi per materialet inerte. Kontrata te shoqerohet me leje mjedisore.

ARGUMENTIMI: Kjo kerkese eshte bere ne perputhje me nenin 39 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe i sherben AK per tu siguruar mbi mbarevajtjen e zbatimit te kontrates dhe mbi marrjen e masave nga ana e ofertuesve per furzrimet e materialeve bazike, cka do te siguronte fillimin e menjehershem te punimeve sapo te nenshkruhet kontrata.

2.3.14 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **100 (njeqind)** punonjes, me kohe te plote, për periudhën **per 3 muajt e fundit** e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **per 3 muajt e fundit**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **per 3 muajt e fundit**.

ARGUMENTIMI: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht analizat e çmimeve jane hartuar sipas parashikimeve të VKM Nr.514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Në pikën 2 të VKM së sipërcituar parashikohet se: “*Hartimi i çdo preventivi apo situacioni në fushën e ndërtimit, si dhe zbatimi e mbikëqyrja e çdo punimi ndërtimi, që realizohet nga persona fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, me fonde publike ose private, në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhen në përputhje me këtë vendim*”.

Mbi bazen e kesaj VKM referuar zerave te preventivit eshte bere perlllogaritja e numrit te punonjesve dhe numrit te mjeteve, sipas secilit tip apo lloj.

SQARIM PER OE: Vetedeklarim nga Operatori Ekonomik ku te deklarohet dhe te paraqiten :

- Kopje të Çertifikatës elektronike për Fiskalizimin, për Tatimpaguesit që përdorin Platformen Qendrore të Faturave.

- Kopje të Çertifikatës elektronike për Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me Shoqërinë e Çertifikuar për zgjidhjen softwerve-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes software-ike.

-Vetedeklarim i postes zyrtare elektronike te subjektit.

ARGUMENTIMI: Kjo kerkese eshte bere në bazë të ligjit Nr.87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” si dhe Njoftimit të përbashkët të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Nr.25366 Prot, datë 30.12.2020 dhe Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.8480 Prot, datë 30.12.2020, per te qene OE i suksesshem për nënshkrimin e një kontrate në përfundim të procedurës.

Ne rastet e pjesemarrjes se operatoreve ekonomik te huaj, detyrimisht te gjitha dokumentat te jene te apostiluar sipas legjislacionit ne fuqi.

Argumentimi i specifikimeve teknike

ARGUMENTIMI: Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës dhe nuk përmbajne asnjë reference te ndonje market e vecante, duke pershkruar ne menyre te qarte dhe te kuptushme çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ne perputhje me *me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*,

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose

shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA PROKURIMIT